



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1288 prot.

Tiranë, më 08/03/2020

URDHËR

Nr. 131, datë 08 . 03 .2020

PËR

NDALIMIN E EKSPORTIT E BARNAVE DHE TË PAJISJEVE MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat "c", të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 8.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri" si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

U R D H Ë R O J:

1. Ndalimin e eksportit të barnave dhe të pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë, deri në një urdhër të dytë.
2. Eksporti i barnave dhe pajisjeve mjekësore do të kryhet vetëm me autorizim të posaçëm të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të ndërrmarë të gjitha veprimet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për zbatimin e këtij urdhëri,
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe të gjithë subjektet që kryejnë eksport të barnave dhe pajisjeve mjekësore, nga Republika e Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

